

FATJONA QURKU

Titulli: “Master i Shkencave”

Fusha e ekspertizës kërkimore: Shkenca Politike, Politologji

Msc. Fatjona Qurku, është diplomuar në Universitetin e Bukureshtit, Fakultetin e Shkencave Politike, në vitin 2007, për Shkenca Politike. Në vitin 2009 ma marrë gradën Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Politika Publike nga Shkolla Kombëtare e Studimeve Politike dhe Administrative, po në Bukuresht. Gjatë periudhës së studimit është angazhuar në projekte rinore me bazë sistemet e qeverisjes dhe pjesëmarrjen.

Që prej vitit 2010, është e angazhuar si pedagoge në Universitetin Marin Barleti, në Departamentin e Shkencave Politike ku dhe mban detyrën e koordinatores së departamentit. Gjithashtu ajo ka qenë e angazhuar si drejtuese e Zyrës së Pranimeve dhe Zyrës Alumni dhe Karriera gjatë periudhës 2010 – 2015.

Msc. Fatjona Qurku ka një pjesëmarrje të gjatë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare me fokus sistemet e qeverisje, demokratizimin, partitë politike, etj, dhe një përvojë të gjatë në mësimdhënie në lëndët: “Hyrje në Shkenca Politike”, “Qeverisje e Krahasuar”, “Historia e Institucioneve”, “Partitë Politike”, etj.